



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 03 .

Prishtinë, më 30.10.2017 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i komisionit- Igor Simić, zëvendëskryetar: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, anëtarët tjerë: Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Živković, Saša Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Sinik dhe Duda Balje.

Nga pjesëmarrësit tjerë: përfaqësues nga Zyra Zvicrane Hajrudin Skenderi; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinautore e Komisionit- Natasa Prica-Tishma, zyrtare e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit - *Igor Simić*,

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, me theks të veçantë tha se është i përoveligjuar që si kryesues udhëheq Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe njëherit përshëndet përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, me raport amandamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa.

Kryetari, veçoi, se në bazë të vendimit Nt. 06-V-009 të datës 26.10.2017, Kuvendi e ka ngarkuar Komisionin për të Dretjat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim të shqyrtoj Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, dhe të shqyrtojë raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim apo sygjerim në Projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL. Anëtarët e komisionit nuk paraqitën propozime konkrete dhe të njëjtin e hodhi në votim.

Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, kryesuesi konstatoi se Komisioni, me njëmëdhjet vota Per, dhe një kundër të anëtarit Xhelal Sveçla, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 06/L-002, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.*
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.*

3. Të ndryshme.

Kryetari, pasi nuk kishte çështje për shqyrtim, konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Përgatitur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simić